

LIGJ
Nr. 169/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË HUNGARISË
PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Hungarisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2014

Shpallur me dekreten nr. 8870, datë 29.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË HUNGARISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË
INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Hungarisë (më poshtë të quajtura “palët”),

Duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit reciprok;

Duke qenë të ndërgjegjshëm se bashkëpunimi i mirë kërkon shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve,

Duke njohur se ato sigurojnë mbrojtje të barasvlershme të informacionit të klasifikuar,

Me dëshirën për të siguruar mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet tyre ose ndërmjet subjekteve juridike ose individëve nën juridiksionin e tyre,

Kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

1. Synimi i kësaj Marrëveshjeje është sigurimi i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ose të gjeneruar në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet palëve ose subjekteve juridike apo individëve nën juridiksionin e tyre.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Informacion i klasifikuar” është çdo informacion që pavarësisht nga forma ose natyra e tij, në bazë të legjislacionit të brendshëm të një Pale, kërkon mbrojtje ndaj deklarimit të paautorizuar ose një manipulimi tjetër të paautorizuar dhe që është përcaktuar rregullisht.

b) “Kontratë e klasifikuar” është një kontratë që përfshin ose kërkon akses në informacionin e klasifikuar;

c) “Palë e origjinës” është Pala, duke përfshirë subjektet juridike ose individët nën juridiksionin e saj, e cila nxjerr Informacionin e Klasifikuar.

d) “Palë marrëse” është pala, duke përfshirë subjektet juridike ose individët nën juridiksionin e saj, e cila nxjerr informacionin e klasifikuar.

e) “Palë e tretë” është çdo shtet, duke përfshirë subjektet juridike ose individët nën juridiksionin e tij ose një organizatë ndërkombëtare, që nuk është palë në këtë Marrëveshje.

f) “Leje sigurie personeli” është certifikata e dhënë nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë për një shtetas të një pale për akses tek informacioni i klasifikuar, në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

g) “Leje sigurie strukture” është certifikata e dhënë nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë që përcakton se një shoqëri/strukturë është me leje sigurie për të trajtuar informacionin e klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme.

h) “Nevoja për të ditur” është një parim, i cili synon aksesin në informacionin e klasifikuar. Ky informacion lejohet vetëm për individët që kanë një nevojë për të verifikuar informacionin e klasifikuar në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre zyrtare.

i) “Vizitorë” janë përfaqësues zyrtarë të një pale që kërkojnë të vizitojnë mjediset e palës tjetër të përfshirë në aktivitete që lidhen me informacionin të klasifikuar.

Neni 3

Autoritetet kompetente të sigurisë

1. Autoritetet kompetente të sigurisë të palëve përgjegjëse për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

a) Në Republikën e Shqipërisë

- Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare);

b) Në Hungari:

- Autoriteti i Sigurisë Kombëtare;

- Nemzeti Biztonsági Felügyelet

2. Autoritetet Kompetente të Sigurisë i japin njëri-tjetrit të dhënat e kontaktit zyrtar dhe njoftojnë njëritjetrin për çdo ndryshim të mëvonshëm.

Neni 4

Nivelet dhe shënjimet e klasifikimit të sigurisë

Barazvlershmëria e niveleve dhe shënjimeve të klasifikimit të sigurisë kombëtare është si më poshtë:

Në Republikën e Shqipërisë	Në Hungari:	Ekuivalenti në gjuhën angleze
Tepër sekret	“Szigorúan titkos!”	TOP SECRET
Sekret	“Titkos!”	SECRET
Konfidencial	“Bizalmas!”	CONFIDENTIAL
I kufizuar	“Korlátozott terjesztésű!”	RESTRICTED

Neni 5

Aksesi në informacionin e klasifikuar

Aksesi në informacionin e klasifikuar sipas kësaj Marrëveshjeje lejohet vetëm për individët e autorizuar rregullisht në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të palës përkatëse.

Neni 6

Parimet e sigorisë

1. Pala e origjinës:

- a) siguron që informacioni i klasifikuar të shënjohej me shënimet e duhura të klasifikimit të sigurisë, në pajtim me legjislacionin e brendshëm;
- b) informon palën pritëse për çdo kusht në përdorimin e informacionit të klasifikuar;
- c) informon palën pritëse pa vonesë për çdo ndryshim të mëvonshëm në nivelin e klasifikimit të sigurisë.

2. Pala marrëse:

- a) siguron që informacioni i klasifikuar të shënjohej me shënjet e barasvlershme të klasifikimit të sigurisë në pajtim me nenin 4;
- b) ofron të njëjtën shkallë mbrojtjeje të informacionit të klasifikuar që i jepet informacionit të saj të klasifikuar me nivel të barasvlershëm të klasifikimit të sigurisë;
- c) siguron që informacioni i klasifikuar të mos deklasifikohet dhe niveli i klasifikimit të sigurisë të mos ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës;
- d) siguron që informacioni i klasifikuar të mos i jepet një palë të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës;
- e) e përdor informacionin e klasifikuar vetëm për qëllimin që është dhënë dhe në pajtim me kushtet e dhënies nga pala e origjinës.

Neni 7

Bashkëpunimi për sigurinë

1. Me qëllim që të ruhen standardet e krahasueshme të sigurisë, Autoritetet Kompetente të Sigurisë njoftojnë me shkrim njëri-tjetër për ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme dhe çdo ndryshim të rëndësishëm në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe praktikën që rrjedhin nga zbatimi i tyre.

2. Me kërkesë, Autoritetet Kompetente të Sigurisë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme, ndihmojnë njëri-tjetrin gjatë procedurave të lejeve të sigurisë së personelit dhe procedurave të lejeve të sigurisë së strukturës.

3. Palët, me kërkesë dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme, njohin certifikatat e lejeve të sigurisë së personelit dhe certifikatat e lejeve të sigurisë së strukturës të lëshuara nga pala tjetër.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë njoftojnë menjëherë njëri-tjetrin në lidhje me ndryshimet në certifikatat e njohura të lejeve të sigurisë së personelit dhe certifikatat e lejeve të sigurisë së strukturës, veçanërisht në rastin e tërheqjes ose uljes së nivelit të tyre.

Neni 8

Kontratat e klasifikuara

1. Kontratat e klasifikuara lidhen dhe zbatohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të secilës palë. Me kërkesë, Autoritetet Kompetente të Sigurisë konfirmojnë që kontraktorët e propozuar si dhe individët që marrin pjesë në bisedimet para-kontraktuale ose në zbatimin e kontratave të klasifikuara, të kenë certifikata të përshtatshme të lejeve të sigurisë së personelit dhe

certifikata të lejeve të sigurisë së strukturës.

2. Autoriteti Kompetent i Sigurisë mund t'i kërkojë homologut të tij që të kryhet një inspektim sigurie në një strukturë të vendosur jashtë territorit të palës tjetër për të siguruar mbrojtjen e vazhdueshme të informacionit të klasifikuar.

3. Kontratat e klasifikuara përmbajnë udhëzime për sigurinë e projektit mbi kërkesat e sigurisë dhe nivelin e klasifikimit të sigurisë të çdo elementi të kontratës së klasifikuar. Një kopje e udhëzimeve të sigurisë së projektit i paraqitet Autoritetit Kompetent të Sigurisë të palës nën juridiksionin e të cilit zbatohet kontrata e klasifikuar.

Neni 9

Transferimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar përcillet në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të palës së origjinës nëpërmjet kanaleve diplomatike ose siç bihet ndryshe dakord ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë në protokollet ekzekutive. Pala pritëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Palët mund të transmetojnë informacion të klasifikuar me mjete elektronike në pajtim me procedurat e sigurisë të miratuara nga Autoritetet Kompetente të Sigurisë.

Neni 10

Riprodhimi, përkthimi dhe asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Riprodhimet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje kanë shënimet e përshtatshme të klasifikimit të sigurisë dhe mbrohen si origjinalet. Numri i kopjeve kufizohet tek ai që kërkohet për qëllime zyrtare.

2. Përkthimet e informacionit të klasifikuar të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje kanë një shënim në gjuhën e përkthimit që tregon se ato përmbajnë informacion të klasifikuar të palës së origjinës.

3. Informacioni i klasifikuar i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje, i shënuar tepër sekret/ "Szigorúan titkos!"/TOP SECRET përkthehet ose riprodhohet vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

4. Informacioni i klasifikuar asgjësohet pasi konfirmohet që nuk vazhdon të mbetet i nevojshëm për qëllimet e transferimit, në një mënyrë që përjashton rindërtimin e tij të pjesshëm ose të plotë. Pala e origjinës njoftohet në lidhje me asgjësimin sa më shpejt të jetë e mundur.

5. Informacioni i klasifikuar i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje, i shënuar tepër sekret/ "Szigorúan titkos!"/TOP SECRET nuk asgjësohet por i kthehet palës së origjinës.

6. Në rastin e një situatë krize në të cilën nuk është e mundur mbrojtja ose kthimi i informacionit të klasifikuar te pala e origjinës, ai asgjësohet menjëherë.

Neni 11

Vizitat

1. Vizitat që kërkojnë akses në informacionin e klasifikuar i nënshtrohen pëlqimit paraprak me shkrim të autoritetit përkatës kompetent të sigurisë.

2. Kërkesat për vizitë i paraqiten autoritetit kompetent të sigurisë jo më vonë se njëzet ditë para kryerjes së vizitës, i cili ia kalon atë autoritetit kompetent të sigurisë të palës tjetër. Në raste urgjente, kërkesa për vizitë i nënshtrohet bashkërendimit të drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë.

3. Kërkesat për vizitë përmbajnë:

- a) emrin, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë dhe numrin e pasaportës/kartës së identitetit të vizitorit;
 - b) pozicionin e vizitorit dhe specifikimin e subjektit juridik që përfaqësohet;
 - c) statusin e certifikatës së lejes së sigurisë së personelit për vizitorin dhe vlefshmërinë e saj;
 - d) datën dhe kohëzgjatjen e vizitës; në rastin e vizitave periodike, periudhën e plotë kohore që mbulohet nga vizitat;
 - e) qëllimin e vizitës, duke përfshirë nivelin më të lartë të klasifikimit të sigurisë të informacionit të klasifikuar përkatës;
 - f) emrin dhe adresën e strukturës që vizitohet, si dhe emrin, numrin e telefonit/faksit, adresën e e-mail-it ose pikën e tij të kontaktit;
 - g) datën, nënshkrimin dhe vulën zyrtare të Autoritetit Kompetent të Sigurisë.
4. Autoritetet kompetente të sigurisë mund të bien dakord për një listë vizitorësh që kanë të drejtën e vizitave periodike. Autoritetet kompetente të sigurisë bien dakord për të dhënat e mëtejshme të vizitave periodike.
5. Informacioni i klasifikuar i përfutur nga një vizitor konsiderohet si informacion i klasifikuar i marrë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Shkelja e sigurisë

1. Autoritetet kompetente të sigurisë njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim pa vonesë për shkeljen e sigurisë që sjell një deklaram të paautorizuar, humbje, asgjësim, përfutim të papërshtatshëm ose një lloj tjetër cenimi të informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ose të gjeneruar sipas kësaj Marrëveshjeje ose dyshimi për të.
2. Autoriteti kompetent i sigurisë së palës ku ka ndodhur shkelja e sigurisë fillon hetimin e incidentit pa vonesë. Nëse kërkohet, autoriteti tjetër kompetent për sigurinë bashkëpunon në hetim.
3. Në çdo rast, autoriteti kompetent i sigurisë i palës marrëse njofton me shkrim palën e origjinës në lidhje me rrethanat e shkeljes së sigurisë, masën e dëmit, masat e marra për zbutjen e tij dhe rezultatin e hetimit.

Neni 13

Shpenzimet

Secila Palë mbulon shpenzimet e veta të bëra gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit ndërmjet palëve, nëpërmjet kanaleve diplomatike, i cili përcakton se procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë përmbushur.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet mbi bazën e pëlqimit reciprok me shkrim të palëve. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.
3. Secila palë ka të drejtë ta prishë këtë Marrëveshje me shkrim në çdo kohë. Në një rast të tillë, vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje skadon pas gjashtë muajsh pas datës në të cilën pala tjetër merr njoftimin me shkrim për zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje.

4. Pavarësisht prishjes së Marrëveshjes, i gjithë informacioni i klasifikuar, i shkëmbyer ose i gjeneruar sipas kësaj Marrëveshje mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje, derisa pala e origjinës ta lirojë palën marrëse nga ky detyrim me shkrim.

5. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe bisedime ndërmjet palëve, pa iu drejtuar juridiksionit të jashtëm.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Budapest, më 8 shtator 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, hungareze dhe angleze, ku secili tekst është njëlloj i vlefshëm. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.